



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 177 prot.

Kamëz, më 19. 12. 2024

V E N D I M  
Nr. 133. Datë 19 / 12 2024  
M B I

**“DHËNIE NDIHME EKONOMIKE PËR FAMILJET NË NEVOJË NGA  
BUXHETI I BASHKISË”**

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 19.12.2024, pasi mori në shqyrtim projekt-vendimin Nr.92 Datë 13.12.2024 në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronjat “a” dhe “b”, nenit 24, nenit 55, pika 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të ndryshuar, ligji nr.57/2019 neni 21 datë 18/07/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, Kreu IV, të Vendimit nr. 597 datë 04/09/2019 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, VKB nr.103 dt 18.12.2023 “ Mbi detajimin e buxhetit për vitin 2024, 2025, 2026; VKB nr. 6 datë 22.01.2024 mbi “Miratimin e kriterëve për trajtimin me ndihmë ekonomike për familjet në nevojë nga buxheti i bashkisë për vitin, 2024, Këshilli Bashkiak Kamëz”;

V E N D O S I:

1. Miratimin e përdorimit të të ardhurave të bashkisë për ndihmë ekonomike për 108 familje me një fond prej 1,078,000 (një milion e shtatëdhjetë e tetëmijë) lekë për muajin Dhjetor 2024. Fondi do të përballohet sipas strukturës buxhetore Gr 0, prog., 10430, Kap.5, Art 606.
2. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimit të nenit 55, pika 6, të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të ndryshuar.

KRYETAR KËSHILLI  
Hysen KOLDASHI

